



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Stalnog Sekretara / Office of the General Secretary

DATË/A:	24.06.2022
REFERENC-Ë:	3154/22 - ZSP- 2022
PËR/ZA/TO:	„GRASEP” Sh.P. K. Fsh. Slatinë e epërme , K. VITI
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Z. Servet SPAHIU, Zavendësues - Sekretar i Përgjithshëm i MMPHI-së Z. Naser AFIZI, Zavendësues i drejtorit të ARPL-së Znj. Makfirete DIBRANI, Udhëheqëse e DMRU-së
NGA/OD/FROM:	Myvedete MUJA, Zyrtare e Lartë për të drejtën ujore
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	VENDIM - LEJE UJORE

Të nderuar,

Autoriteti Rajonal i Pellgjeve Lumore i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, ka shqyrtuar kërkesën dhe dokumentacionin tekniko-investigativ, me Nr. të protokollit: 3154/22, parashtruar nga „GRASEP” Sh.P.K., fsh Vitomiricë K, Pejë dhe ka vendosur si në Vendim për Leje Ujore, të bashkangjitur kësaj shkrese përcjellëse.

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Stalnoq Sekretara / Office of the General Secretary

Nr. LU

Datë: 24.06.2022

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019, shtojcës 1 pika 10 të Rregullorës (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrave, nenin 71 të Ligjit Nr. 04/L -147 Për Ujërat e Kosovës, nenit 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dispozitave ligjore të Udhëzimit Administrativ, MMPH Nr. 03/2018 për Procedurat për Leje Ujore, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, nxjerrë këtë:

V E N D I M

APROVOHET kërkesa e palës, „GRASEP”, Sh. P.K. Fsh Sllatinë e Epërme, K. VITI për LEJE UJORE, për shkarkim të ujit nga Fabrika për Prodhimin e Pemëve dhe Perimeve, në parcelen kadastrale, me Nr P-70101037-02394-2 në pikën koordinative (X = 7 523 761; Y= 4 692 360), sipas kushteve vijuese:

Leja Ujore jepet me këto kushte:

1. Leja Ujore lëshohet në bazë të dokumentacionit tekniko – investiv për kompleksin e objekteve nën kushtet vijuese:
2. Kjo Leje Ujore i referohet ekskluzivisht shkarkimit të ujërave të ndotura nga kompleksi i fabrikës „GRASEP” Fsh. Sllatinë e Epërme, K. VITI;



3. Afati i lëshimit të lejes ujore është 5 (pesë) vite, me mundësi zgjatjeje sipas kërkesës së palës;
4. Objektet me destinim të grumbullimit, trajtimit të ujërave të ndotur, llumit dhe ato të shkarkimit duhet të mirëmbahen rregullisht dhe të shfrytëzohen në atë mënyrë që të sigurojnë funksionalitet të plotë;
5. Nëse gjatë operimit vije deri të ndryshimi i regjimit të ujërave dhe shkaktimit të dëmeve eventuale mjedisit ose palëve të treta, investitori është i obliguar që dëmet t'i evitohet dhe të njejtat t'i kompenzoj;
6. Që të kryhet monitorimi në të gjitha fazat e trajtimit të efluentit, rezultatet e monitorimit të raportohen në MMPHI / ARPL çdo gjasht muaj;
7. Obligimi financiar sipas "Strukturës së pagesave të ujit " lidhur me shkarkimin ujërave të ndotura do të caktohet me vendim të posaçëm në rast se analizat e ujit nuk i plotësojnë kriteret sipas Udhëzimit Administrativ në fuqi, për efluentin;
8. Të drejtat e fituara në bazë të Lejes Ujore nuk mund t'u barten personave të tretë pa pajtimin e organit i cili ka lëshuar këtë Leje Ujore;
9. Për vazhdimin e Lejes Ujore bartësi është i obliguar që të aplikoj se paku 2 (dy) muaj para skadimit të afatit të Lejes Ujore;
10. Validiteti i Lejes Ujore pushon në rast të mos plotësimit të kushteve të lartcekura në afatet e parapara kohore.

Arsyetim

Zyrtarët përgjegjës, duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ MMPHI Nr. 03/2018 për Procedurat për Leje Ujore dhe procedurave të përcaktuara me legjislacionin e ndërtimit, kanë shqyrtuar dokumentacionin e palës për aplikim për Leje ujore shfrytëzim i ujit nga pusi për fabrikën e përpunimit të pemëve dhe perimeve të cilit iu janë bashkangjitur: Certifikate e Regjistrimit të Biznesit; Vendimi për pëlqim mjedisorë ,me Nr. 20/4101/1-ZSP/ /20 datë 30.11.2020; Certifikata mbi pronësinë, të pronës P-70101037-02394-2; Kopje e planit :zona kadastrale Sllatine, Zyra kom. Viti; .Faturat e pagesave për KU, PU dhe LU.



Trajtimi i ujërave të ndotura kryhet përmes gropave septike, nga fabrika dhe atyre sanitare. Uji i shkarkuar i cili perdoret gjatë procesit të prodhimit dhe ai sanitar kontrollohet rregullisht

Pala gjithashtu ka kryer pagesat sipas shtojces 6 të U.A. 03/2018 për proceduratb per leje ujore për kushte ujore, pëlqim uxor dhe Leje ujore. Andaj bazuar në këtë si më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nxjerrjes.

KËSHILLA JURIDIKE :

Pala e pakënaqur, ka të drejtë në iniciimin e procedurës së Kontestit administrativ, në Gjykatën Kompetente të Kosovës, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

Nr. : 3154/22 - ZSP- 2022, datë: 24.06.2022

Prishtinë

T'i dërgohet:

- Palës;
- Zyrës se Sekretarit të Përgjithshëm;
- ARPL-së;
- Inspektoratit të MMPHI-së;
- Komunës Viti;
- Arkivit të Ministrisë.

Zavendësues - Sekretar i Përgjithshëm i MMPHI-së

